

**Lengarica & Energy sh.p.k.**  
**Pasqyrat Financiare sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit**  
**për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Përmbajtje

Raporti i audituesit të pavarur .....	i
Pasqyra e pozicionit financiar .....	1
Pasqyra e performancës dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse .....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital .....	3
Pasqyra e flukseve monetare .....	4
1. Informacion i përgjithshëm.....	5
2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare .....	5
3. Politikat e rëndësishme kontabël.....	6
4. Standardet e reja të kontabilitetit dhe interpretimet e tyre .....	10
5. Mjetet monetare dhe ekuivalente.....	12
6. Aktive të tjera afatshkurtra .....	12
7. Aktive afatgjata materiale.....	13
8. Llogari të arkëtueshme nga konçensionit .....	13
9. Aktive afatgjata jo-materiale .....	13
10. Aktive afatgjata të tjera .....	13
11. Llogari të pagueshme .....	14
12. Detyrime të tjera.....	14
13. Huamarrjet .....	14
14. Kapitali i paguar .....	14
15. Të ardhurat .....	15
16. Shpenzime për personelin .....	15
17. Shpenzime të veprimtarisë .....	15
18. Të ardhura dhe shpenzime financiare .....	15
19. Tatim fitimi.....	16
20. Palë të lidhura .....	16
21. Angazhime dhe detyrime e të drejta të kushtëzuara .....	17
22. Menaxhimi i riskut financiar.....	17
23. Ngjarje pas datës së raportimit.....	19

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Aksionarëve të Lengarica & Energy sh.p.k

### Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Lengarica & Energy sh.p.k (“Shoqëria”) më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri (“SKK”).

#### Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016;
- pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

### Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA”). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

#### Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (“kodi i BSNEK”), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

### Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat Drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një prishmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Drejtimi.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

*PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k*

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k  
Tiranë, Shqipëri  
20 prill 2017



*Laureta Peci Kellici*  
Auditues ligjor  
Laureta Peci Kellici

**Lengarica & Energy sh.p.k**  
**Pasqyra e pozicionit financiar**

**Më 31 Dhjetor 2016**

(shumat në Lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>Aktivitet</b>			
<b>Aktivitet afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	5	212,720,612	453,071,963
Aktive të tjera afatshkurtra	6	330,455,635	203,309,448
Tatim fitimi i arkëtueshëm		140,000	175,000
Inventar		43,585	-
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>543,359,832</b>	<b>656,556,411</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktivitet afatgjata materiale	7	1,877,096	2,148,992
Llogari të arkëtueshme nga konçesioni	8	1,147,979,779	1,229,935,478
Aktive afatgjata jomateriale	9	1,639,913,971	1,639,913,971
Aktive afatgjata të tjera	10	31,598,610	14,648,342
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>2,821,369,456</b>	<b>2,886,646,783</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>3,364,729,288</b>	<b>3,543,203,194</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme	11	226,263,070	327,186,785
Detyrime të tjera afatshkurtra	12	1,899,217	12,844,713
Detyrim tatim fitimi i shtyre	19	9,230,516	-
Huamarrjet	13	167,406,238	218,187,947
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>404,799,041</b>	<b>558,219,445</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Huamarrjet	13	2,508,528,829	2,535,209,661
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>2,508,528,829</b>	<b>2,535,209,661</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>2,913,327,870</b>	<b>3,093,429,106</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i paguar	14	733,000,000	733,000,000
Humbjet e akumuluar		(281,598,582)	(283,225,912)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>451,401,418</b>	<b>449,774,088</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>3,364,729,288</b>	<b>3,543,203,194</b>

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 19, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Lengarica & Energy sh.p.k. më 29 Mars 2017, dhe janë firmosur në emër të tij nga

Aida Nani  
 Administratore e përgjithshme

REZARTI KOÇIJA  
 EKSPERTI KONTABËL  
 RAZANA KOÇIJA  
 Kontabilist



**Lengarica & Energy sh.p.k.**  
**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

(shumat në Lekë)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
<b>Të ardhura</b>			
Shitje energjie		365,613,572	38,401,955
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzime të personelit			
Paga dhe shpërblime		(9,681,548)	(4,495,941)
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	16	(1,027,138)	(428,270)
Shpenzime të veprimtarisë	17	(222,427,157)	(37,627,455)
Shpenzime të amortizimit	7	(447,190)	(627,247)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(233,583,033)</b>	<b>(43,178,913)</b>
<b>Fitimi/ (Humbja) nga veprimtaria kryesore</b>		<b>132,030,539</b>	<b>(4,776,958)</b>
<b>Të ardhurat dhe shpenzimet financiare</b>	18		
Fitim/humbje nga kursi i këmbimit		38,749,052	56,050,373
Shpenzime interesi		(159,921,745)	(151,141,759)
Të ardhura operative të tjera		-	4,271,508
<b>Të ardhurat dhe shpenzimet financiare neto</b>		<b>(121,172,693)</b>	<b>(90,819,878)</b>
<b>Fitimi/(Humbja) para tatimit</b>		<b>10,857,846</b>	<b>(95,596,836)</b>
Tatimi mbi fitimin	19	-	-
Tatim fitimi i shtyre		(9,230,516)	-
<b>Fitimi/(Humbja) e vitit</b>		<b>1,627,330</b>	<b>(95,596,836)</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave/(humbjeve) gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>1,627,330</b>	<b>(95,596,836)</b>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 19, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**Lengarica & Energy sh.p.k.**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

*(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

	<b>Kapitali i paguar</b>	<b>Humbja e akumuluar</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendje më 1 janar 2015</b>	<b>733,000,000</b>	<b>(187,629,076)</b>	<b>545,370,924</b>
Humbja e vitit	-	(95,596,836)	(95,596,836)
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2015</b>	<b>733,000,000</b>	<b>(283,225,912)</b>	<b>449,774,088</b>
Humbja e vitit	-	1,627,330	1,627,330
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2016</b>	<b>733,000,000</b>	<b>(281,598,582)</b>	<b>451,401,418</b>

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 19, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**Lengarica & Energy sh.p.k.**  
**Pasqyra e flukseve monetare**

*(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
<b>Humbja para tatimit</b>			
<i>Rregullime për:</i>			
Shpenzime të amortizimit	7	447,190	627,247
Zhvleresim i aktiveve koncesionare	8	81,955,699	-
Tatim fitimi i shtyre		-	-
Shpenzime interesi			151,141,759
<b>Fitimi operativ përpara ndryshimit në kapitalin qarkullues</b>			
		<b>93,260,735</b>	<b>56,172,170</b>
(Rritje)/Rënie në aktive të tjera afatshkurtra	6	(127,154,772)	27,510,352
(Rënie) në tatim fitim		35,000	-
Rritje ne inventar		(43,585)	-
(Rënie)/Rritje në llogaritë e pagueshme	11	(100,923,715)	128,410,915
(Rënie)/Rritje në detyrime të tjera	12	(10,945,496)	11,301,044
(Rritje)/Rënie në aktive të tjera afatgjata	10	(16,950,268)	74,624,248
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
Interesi i paguar		-	(92,050,093)
<b>Flukset monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
		<b>(162,713,516)</b>	<b>205,968,636</b>
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë e investimit</b>			
Aktive afatgjata materiale	7	(175,294)	(174,001)
Llogari të arkëtueshme nga konçesioni	8	-	(422,451,242)
Të drejta të tjera afatgjata	9	-	(563,268,324)
<b>Flukset monetare neto përdorur në veprimtaritë e investimit</b>			
		<b>(175,294)</b>	<b>(985,893,567)</b>
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë e financimit</b>			
Rritje në hua	13	-	1,290,481,387
Hua të paguara		(77,462,541)	(261,222,733)
<b>Flukset monetare neto nga veprimtaritë e financimit</b>			
		<b>(77,462,541)</b>	<b>1,029,258,654</b>
<b>(Rënie)/rritje neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente</b>			
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalente në fillim të periudhës</b>			
	6	453,071,963	203,738,240
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalente në fund të periudhës</b>			
	6	<b>212,720,612</b>	<b>453,071,963</b>

Pasqyra e Flukseve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 19, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



## **1. Informacion i përgjithshëm**

Lengarica & Energy sh.p.k. është një filial i zotëruar në masën 99.9% nga shoqëria Enso Hydro Energji sh.p.k. (me seli në Tiranë, Shqipëri), e cila nga ana e saj është filial i enso hydro GmbH (80%), shoqëria mëmë me seli në Austri. Aksionet e mbetura janë në pronësi të Hasi Energji sh.p.k., shoqëri e cila është gjithashtu në pronësi të shoqërisë mëmë të Lengarica & Energy.

Shoqëria është themeluar më 25 qershor 2008 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numrin unik të identifikimit K83026602A dhe seli në Tiranë, Shqipëri.

Veprimtaria kryesore e shoqërisë është ndërtimi, përdorimi, blerja dhe shitja e hidrocentraleve, prodhimi i energjisë elektrike dhe shitja e saj për klientët dhe distributorët me shumicë.

Administratorët e Përgjithshëm të Shoqërisë janë Znj. Aida Nani dhe Z. Georg Schweighofer.

Selia e shoqërisë është në Rr. "Jul Variboba", Vila Nr 10, Tiranë, Shqipëri.

Numri i personelit më 31 dhjetor 2016 është 9 (31 dhjetor 2015: 9).

### **Kontrata konçesionare**

Në përputhje me kontratën e konçesionit të formës BOT (Ndërtim, Operim, Transferim) të datës 17 Prill 2008 (kontrata e konçesionit) ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Konçesionari), bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 136, datë 14.03.2007 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për dhënien me konçesion të hidrocentralit Lengarica 1 dhe Lengarica 2", ndryshuar më 25 Prill 2009, dhe Shoqërisë Hasi Energji sh. p. k., kjo e fundit krijoi Shoqërinë Lengarica & Energy sh. p. k., me qëllimin e vetëm për të implementuar Kontratën e Konçesionit.

Pas themelimit më 25 qershor 2008, Shoqërisë Lengarica & Energy sh.p.k. i janë transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që vijnë si rrjedhim i Kontratës së Konçesionit. Hasi Energji sh.p.k. është përgjegjëse për zbatimin e kontratës deri në momentin kur Shoqëria kryen punimet, të cilat filluan më 2013.

Autoriteti Kontraktues garanton blerjen e prodhimit të energjisë elektike nga KESH sh.a. për 15 vitet e para të prodhimit. Pas kësaj periudhe, Shoqëria mund të shesë energjinë elektrike të prodhuar në tregun e lirë.

Bazuar në ndryshimin e Kontratës së Konçesionit më 25 prill 2009 dhe 16 Korrik 2014, Shoqëria do të ndërtojë dhe shfrytëzojë vetëm një hidrocentral, atë të Lengaricës në komunën e Petranit të rrethit të Përmetit me një fuqi të instaluar prej 8,906 kW për një prodhim energjie në masën e 32,190,000 kW/h përgjatë 35 viteve të kontratës së konçesionit (në vend të 2 hidrocentraleve siç ishte planifikuar fillimisht në Kontratën e Konçesionit). Shoqëria ka vendosur në punë hidrocentralin në dhjetor të vitit 2015 dhe ka filluar prodhimin dhe shitjen e energjisë për KESH-in.

Investimi total miratuar është në shumën e 1,908,714 mijë Lekë. Tarifa e konçesionit që duhet paguar nga Shoqëria është në masën 2.1% të energjisë së prodhuar. Gjithashtu, Shoqëria është e detyruar të investojë 42% të vlerës totale të investimeve në makineri dhe pajisje në mënyrë që të transferojë hidrocentralin në kushte të plota operative.

Periudha e Konçesionit është 35 vjet duke filluar që në dhjetor 2015.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të aplikuar në Shqipëri të aprovuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe të miratuara nga Ministria e Financave.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

### **2.1 Deklarata e pajtueshmërisë (vazhdim)**

Në mungesë udhëzimi nga SKK në lidhje me kontratat e shërbimeve konçesionare, Kontrata e Konçesionit është llogaritur dhe paraqitur në përputhje me KIRFN 12 "Shërbimet e Kontratave të Konçesionit".

### **2.2 Parimi i vijimësisë**

Drejtimi ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimësisë. Në marrjen e këtij vendimi, Drejtimi mori në konsideratë planet e biznesit të Shoqërisë, përfshirë këtu parashikimet e fitimit dhe mjeteve monetare si edhe ecurinë e ndërtimit të aktiveve konçesionare dhe të drejtën e burimeve financiare nga Grupi.

Lengarica&Energy sh.p.k. filloi të gjenerojë të ardhura gjatë 2015. Shitjet janë të garantuara me marrëveshjen e koncensionit me KESH-in deri në vitin 2020.

### **2.3 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

### **2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë dhe monedha e ambientit ekonomik kryesor në të cilin Shoqëria kryen aktivitetin e saj.

### **2.5 Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të ushtrojë gjykim në procesin e vlerësimeve dhe supozimeve që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga këto rishikime.

Në veçanti, informacioni në lidhje me fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurive dhe gjykimeve në zbatimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të konsiderueshëm ndaj shumave të njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Gjykimet në lidhje me trajtimin e kontratës konçesionare dhe aktiveve të lidhura me të paraqitën në këto pasqyra financiare në shënimet 3.2 dhe 3.4.

## **3. Politikat e rëndësishme kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

### **3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi i zërave monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurset e ndryshme përkatëse të këmbimit.

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### **3.2 Instrumente financiarë**

Instrumentet financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

### 3. Politikat e rëndësishme Kontabël (vazhdim)

Instrumentet financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Pas njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjete monetare dhe ekuivalente*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit të tyre. Mjetet monetare dhe ekuivalentet njihen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme për llogaritët kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha të drejtat sipas kushteve fillestare të tyre. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme janë të mbivlerësuara. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara monetare të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogaritë e arkëtueshme konçesionare*

Shuma për t'u arkëtuar nga KESH (e drejta e shoqërisë për të kërkuar pagesë nga ana e KESH në lidhje me shitjen e energjisë në 15 vitet e para të veprimtarisë së objektit të konçesionit) njihet në pasqyrat financiare si aktiv financiar (llogari të arkëtueshme nga konçesioni) dhe klasifikohen si të tilla.

Në përputhje me marrëveshjen e konçesionit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shoqëria ka të drejtën të faturojë KESH për shitjen e energjisë elektrike (shitja e të cilës është garantuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) për 15 vitet e para të veprimtarisë së hidrocentralit të Lengaricës.

Vlera e aktivitetit financiar është llogaritur në përpjesëtim të drejtë për periudhën e konçesionit, 15 vjet nga 35 vjet, për të gjitha kostot e ndërtimit deri në datën e raportimit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme njihen me vlerë të drejtë dhe maten më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Huamarrjet*

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe maten më pas me kosto të amortizuar.

#### *Të tjera*

Instrumente të tjerë financiar jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

### 3. Politikat e rëndësishme Kontabël (vazhdim)

#### 3.3 Aktive afatgjata materiale

##### (i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, nëse ka të tilla.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten nën aktive afatgjata jo-materiale dhe aktive financiare dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur zbatohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

##### (ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### (iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve jomateriale dhe përmirësimit të ambienteve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivet e tjera afatgjata mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

#### Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale është si më poshtë:

Kategoritë	Metoda e amortizimit	Norma amortizimit
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%
Mobilie dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

#### 3.4 Aktivet afatgjata jo-materiale (të drejta nga marrëveshja e konçesionit)

Të ardhurat që do të merren nga marrëveshja e konçesionit për ndërtimin e objektit të marrëveshjes njihen me vlerën e drejtë, në përputhje me KIRFN 12.

Shoqëria ka zbatuar modelin e kombinuar të KIRFN 12 në mungesë të udhëzimeve specifike nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Në përputhje me marrëveshjen e konçesionit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shoqëria ka të drejtën të faturojë për shitjen e energjisë elektrike ndaj KESH sh.a (shitja e të cilës është garantuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) për 15 vitet e para të veprimtarisë së hidrocentralit të Lengaricës. Pas kësaj periudhe, Shoqëria është e lirë të shesë energjinë elektrike të prodhuar në treg.

Shuma për t'u arkëtuar nga KESH sh.a. (e drejta e shoqërisë për të kërkuar pagesë nga ana e KESH në lidhje me shitjen e energjisë në 15 vitet e para të veprimtarisë së objektit të konçesionit) njihet në pasqyrat financiare si aktiv financiar (llogari të arkëtueshme nga konçesionit) dhe klasifikohen si të tilla.

### 3. Politikat e rëndësishme Kontabël (vazhdim)

Vlera fillestare përfaqëson diferencën midis kostos së ndeshur për ndërtimin e objektit të konçesionit dhe aktivitetit të njohur financiar.

Modeli i përdorur nga shoqëria është modifikuar duke shpërndarë në përpjesëtim të drejtë shumat midis aktiveve financiare dhe atyre afatgjata jo-materiale.

Duke qenë se shoqëria do të paguhet pjesërisht nga një aktiv financiar (shuma e garantuar) dhe pjesërisht nga aktive afatgjata jo-materiale (diferenca apo e drejta për të përdorur objektin më pas), secili përbërës kontabilizohet veçmas.

#### 3.5 Zhvlerësimi

##### (i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### (ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.6 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

#### 3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

#### 3.8 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3. Politikat e rëndësishme Kontabël (vazhdim)

#### 3.9 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

### 4. Standardet e reja të kontabilitetit dhe interpretimet e tyre

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të Shqipërisë ka nxjerrë disa ndryshime të standardeve ekzistuese të cilat janë miratuar nga Ministria e Financave më 22 Korrik 2014. Standardet e ndryshuara janë të detyrueshme për vitin që fillon më 1 Janar 2015 ose më vonë.

Të gjitha standardet hyjnë në fuqi për periudhat pas 1 Janar 2015.

#### **SKK 1 “Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare” (i ndryshuar)**

Standardi i ri prezanton konceptin e të ardhurave gjithëpërfshirëse (të ardhurat dhe fitimet e realizuara dhe ato të përcaktuara gjatë periudhës); Një kërkesë për shënime shpjeguese është përfshirë në lidhje me ngjarjet që nuk rregullohen pas periudhës së raportimit në mënyrë që të përputhen me kërkesat e SNRF për NVM: “Një entitet duhet të paraqesë informacionet e mëposhtme për çdo kategori të ngjarjeve që nuk rregullohen pas periudhës së raportimit: (a) natyrën e ngjarjes, (b) vlerësim të efektit financiar të saj apo një arsye pse një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet”. Një ndër termat që ndryshon në të gjitha standardet është termi “pasiv” sepse në literaturën ndërkombëtare të kontabilitetit, përfshirë SNRF për NVM, përdoret termi “detyrim”.

Terminologjia dhe prezantimi i pasqyrave financiare pritet të ndikohet nga ndryshimet e këtij standardi.

#### **SKK 2 “Paraqitja e pasqyrave financiare” (i ndryshuar)**

Sipas SKK 2 terminologjia dhe përkufizimet pësojnë ndryshime, por që nuk prekin thelbin e konceptit. Më specifikisht, ndryshojnë emërtimet për pasqyrat financiare sipas SNRF për NVM, konkretisht bilanci emërtohet pasqyra e pozicionit financiar, PASH emërtohet pasqyra e performancës financiare që përfshin edhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Koncepti i vijimësisë sqarohet më në detaje në përputhje me SNRF sipas NVM pa paragrafi 3.9 sipas të cilit Shoqëria duhet të paraqesë pasiguri materiale të cilat hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar me parimin e vijimësisë. Nëse Shoqëria nuk përdor parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare, kjo e fundit duhet të paraqesë parimin mbi të cilin përgatiten pasqyrat financiare dhe arsyen pse parimi i vijimësisë nuk përdoret.

SKK2 prezanton disa kërkesa të reja sipas paragrafëve 5.4/5/6 të SNRF për NVM japin kërkesat për paraqitjen e pasqyrës së vetme të të ardhurave gjithëpërfshirëse. SKK-të e përmirësuara tani e kanë pjesë të tyre konceptin e monedhës funksionale sipas paragrafit 7.12 i SNRF për NVM por kërkohet ndërkohë një amendim ligjor që edhe ligji i kontabilitetit të njohë përdorimin e monedhës funksionale. tashmë ka paragraf të posaçëm që udhëzon për rubrikën në pasqyrën e pozicionit financiar ku duhet të paraqiten dividendët dhe interesat e paguar në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare. Pasqyrat financiare të Shoqërisë pritet të reflektojnë ndryshimet në terminologji.

#### **SKK 3 “Instrumentet financiare” (i ndryshuar)**

SKK3 është ndryshuar për t'u përputhur me paragrafin 11 të SNRF për NVM. Fusha e zbatimit të SKK3 është ngushtuar vetëm për instrumentet e thjeshta financiare, sipas seksionit 11 të SNRF për NVM. Modeli i vlerësimit të mëposhtëm të instrumenteve financiare është vetëm ai i kostos së amortizuar, nuk lejohet më modeli i vlerës së drejtë. Koncepti i matjes fillestare të instrumenteve financiare jepet më i qartë në formulimin sipas SNRF për NVM dhe shënimet shpjeguese janë thjeshtuar.

Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

#### **SKK 4 “Inventarët” (i ndryshuar)**

Sipas SKK 4 nuk përdoret më termi ‘vlera neto e realizueshme’ por thjesht përkufizimi i plotë i saj, që është i njëjtë me atë të dhënë në SNRF për NVM: “shoqëria duhet të masë inventarët me koston më të ulët midis çmimit të shitjes minus koston për t'u përfunduar dhe shitur”. SKK4 parashikon trajtimin kontabël të blerjeve të inventarëve në kushtet e pagesave të shtyra në afate. Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

#### 4. Standardet e reja të kontabilitetit dhe interpretimet e tyre

##### **SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” (i ndryshuar)**

SKK5 prezanton ndryshime që ndikojnë temat e mëposhtme:

Përkufizimi i kostove të huamarrjes bëhet sipas SNRF për NVM, sipas të cilit kostot e huamarrjes janë interes apo kosto të tjera me të cilat shoqëria përballet në raste të huamarrjeve. Kostot e huamarrjeve përfshijnë: shpenzime të interesit të llogaritura sipas metodës së interes efektive të përshkruar në Paragrafin 11: Instrumentet Financiare të thjeshtë b) shpenzimet financiare në lidhje me qiratë financiare të njohura në përputhje me Paragrafin 20 Qiratë c) ndryshimet nga kurset e këmbimit si pasojë e huamarrjeve në monedhë të huaj në masën që ato trajtohen si rregullim i shpezimeve të interesit. Për më tepër, shpenzimet e zhvillimit dhe shpenzimet e interesit (kostot e huamarrjes) trajtohen si shpenzime periudhe, sipas SNRF për NVM dhe nuk mund të kapitalizohen.

Sipas SKK5, shtohet trajtimi kontabël për aktivet afatgjata materiale të investuara si dhe për pjesët e këmbimit dhe pajisjet e tyre, për rastet kur ato trajtohen si aktive afatgjata materiale. Ka më shumë kërkesa dhe udhëzime lidhur me përcaktimin e jetës së dobishme dhe llogaritjes së amortizimit për të dyja llojet e aktiveve, materiale dhe jomateriale dhe për njohjen e një aktivi afatgjatë jomaterial. Emri i mirë amortizohet për 10 vite sipas SNRF për NVM pra nuk testohet për zhvlerësim.

##### **SKK 6 “Provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara” (i ndryshuar)**

Matja e provizioneve trajtohet më e detajuar sipas SNRF për NVM si dhe kërkon më shumë shënime shpjeguese lidhur me provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara. Paragrafët 37-39 të SKK6 që mbulonin provizionet për pensionet, janë hequr.

Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

##### **SKK 7 “Kontabilizimi i qerave” (i ndryshuar)**

SKK 7 parashikon një paragraf të ri ku saktësohen disa përjashtime nga fusha e zbatimit të standardit. Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

##### **SKK 8 “Të ardhurat” (i ndryshuar)**

SKK 8 ka udhëzim të veçantë për matjen e arkëtimeve të shtyra në kohë dhe udhëzime më të thjeshta dhe të detajuara për metodën e fazës së përfundimit. SKK 8 e ndryshuar ka një organizim më të mirë, referuar ndarjes së qartë të udhëzimeve për shitjen e mallrave, ofrimin e shërbimeve, kontrata e ndërtimit dhe metodën e fazës së përfunduar. Për më tepër, ka udhëzime për format e reja të shfaqura të të bërit biznes, siç është p.sh, rasti i lëshimit të kartave të besnikërisë për klientët. Në përgjithësi, përkufizimet janë më të zgjeruara, tashmë janë sipas SNRF për NVM.

Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

##### **SKK 9 “Kombinimet e bizneseve” (i ndryshuar) dhe SKK 14 “Trajtimi kontabël i shoqërive të kontrolluara dhe pjesëmarrjeve” (i ndryshuar)**

SKK 9 ka pësuar një numër ndryshimesh. Vërehet një ndarje e qartë mes çështjeve të kombinimit të bizneseve dhe atyre të investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta dhe shtohet një përkufizim për ‘njësitë ekonomike me qëllim të veçantë’. Kërkesa të reja janë prezantuar për (a) përkufizimin e termin kombinim biznesi (b) trajtimin kontabël të konsolidimit të pasqyrave financiare. Ka udhëzime për pasqyrat financiare të kombinuara ashti si është parashikuar në paragrafët përkatës të SNRF për NVM ndërsa aplikimi i metodës së përshtatur të blerjes së njësive ekonomike që janë në kontroll të përbashkët nuk është më i lejuar. Një blerësi në një kombinim biznesi nuk i kërkohet më të bëjë analiza të vështira të çmimit të blerjes dhe ndryshe nga varianti I mëparshëm ku emri i mire amortizohet, nuk kërkohet më testi i zhvlerësimit për emrin e mire. Tashmë, lejohet përdorimi i vlerës së drejtë për investimet në pjesëmarrje ashtu si në SNRF për NVM.

Në vijim, ka kërkesa të veçanta për rastet kur shoqëria mëmë është e lejuar të mos përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, të cilat nuk ishin më përpara. Shoqëria mëmë është e lejuar të mos përgatisë pasqyra financiare kur:

- a) Të dy kushtet e mëposhtëm plotësohen
  - i. Shoqëria mëmë është filial, dhe
  - ii. Shoqëria mëmë përgatit pasqyra financiare të konsoliduara për qëllime të përgjithshme të cilat janë në përputhje me SNRF për NVM.

**4. Standardet e reja të kontabilitetit dhe interpretimet e tyre**

- b) Nuk ka filiale përveç atyre të cilat janë blerë me qëllim për t'u shitur brenda një viti. Shoqëria mëmë duhet të njohë një filial të tillë:
- Me vlerën e drejtë dhe ndryshimet e vlerës së drejtë duhet të paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, nëse vlera e drejtë e aksioneve mund të matet në mënyrë të besueshme, ose
  - Me kosto minus zhvlerësimin.

Ndryshimet e këtij standardi priten të kenë një ndikim material në pasqyrat e Shoqërisë. Shoqëria nuk përgatit pasqyra financiare të konsoliduara sepse përmbush kushtet e mësipërme të pikës (a).

**SKK 10 “Grantet dhe format e tjera të ndihmës” (i ndryshuar)**

Kërkesat e SKK 10 të përmirësuar janë ndryshuar pasi nuk parashikon më llojet e granteve të ndara në grante në para apo aktive të tjera materiale dhe jo materiale dhe kusht për njohjen e grantit në të ardhura është vetëm plotësimi i performancës duke mos marrë në konsideratë amortizimin e aktivitetit material apo shpenzimet për t'u përballuar nga granti i marrë.

Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

**SKK 11 “Tatimi mbi fitimin” (i ndryshuar)**

SKK 11 është standard i detyrueshëm si SKK-të e tjera. Në të ka paragrafë të rinj që në mënyrë të posaçme mbulojnë trajtimin kontabël të tatimit fitimit aktual dhe tatimit fitimit të shtyrë. Janë hequr udhëzimet për njohjen e aktiveve dhe detyrimeve tatimore për rastet e kombinimeve të bizneseve dhe aktiveve që mbahen me vlerë të drejtë.

Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

**SKK 12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimeve” (i ndryshuar)**

SKK 12 prezanton disa udhëzime të reja për konceptin e monedhës funksionale dhe rrjedhimisht të mjedisit ekonomik primar. Në këtë logjikë, jepen udhëzime për rastet kur monedha raportuese është e ndryshme nga monedha funksionale dhe prezanton udhëzime për investimet në një njësi ekonomike të huaj.

Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

**SKK 13 “Aktivet biologjike” (i ndryshuar)**

Fusha e zbatimit të këtij standardi të përmirësuar përfshin edhe marrëveshjet konçesionare dhe lejon modelin alternativ atë të vlerës së drejtë nëse kjo e fundit gjendet lehtësisht pa kosto shtesë.

Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

**5. Mjetet monetare dhe ekuivalente**

	31.12.2016	31.12.2015
Banka në Lekë	21,157,563	230,929,270
Banka në Euro	191,036,646	222,021,592
Arka	526,403	121,101
<b>Totali</b>	<b>212,720,612</b>	<b>453,071,963</b>

**6. Aktive të tjera afatshkurtra**

	31.12.2016	31.12.2015
TVSH e arkëtueshme	115,879,048	169,839,875
Parapagime	13,646,225	20,238,672
Të arkëtueshme të tjera	200,930,362	13,230,901
<b>Totali</b>	<b>330,455,635</b>	<b>203,309,448</b>

TVSH e arkëtueshme lind nga ndërtimi i aktivitetit konçesionar pasi shërbimet e ofruara nga furnitorët e shoqërisë janë subjekt i TVSH.



**Lengarica & Energy sh.p.k.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**7. Aktive afatgjata materiale**

	Mjete transporti	Mobilie dhe orendi	Pajisje zyrash dhe informatike	Përmirësime të objekteve të marra me qira	Rafte zyrash dhe të tjera	Totali
<b>Kosto</b>						
Më 1 janar 2015	1,967,420	526,946	522,375	146,896	1,002,728	4,166,365
Shtesa	-	54,001	-	-	120,000	174,001
Më 31 dhjetor 2015	1,967,420	580,947	522,375	146,896	1,122,728	4,340,366
Shtesa	-	-	-	-	175,294	175,294
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,967,420</b>	<b>580,947</b>	<b>522,375</b>	<b>146,896</b>	<b>1,184,661</b>	<b>4,402,299</b>
<b>Amortizimi</b>						
Më 1 janar 2015	(748,027)	(283,560)	(249,757)	(12,277)	(270,506)	(1,564,127)
Shtesa	(243,879)	(48,677)	(68,154)	(6,731)	(259,806)	(627,247)
Më 31 dhjetor 2015	(991,906)	(332,237)	(317,911)	(19,008)	(530,312)	(2,191,374)
Shtesa	(195,104)	(49,740)	(51,116)	(6,396)	(144,834)	(447,190)
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(1,187,010)</b>	<b>(381,977)</b>	<b>(369,027)</b>	<b>(25,404)</b>	<b>(675,146)</b>	<b>(2,638,564)</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>						
Më 31 dhjetor 2015	975,514	248,710	204,464	127,888	592,416	2,148,992
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>780,410</b>	<b>198,970</b>	<b>153,348</b>	<b>121,492</b>	<b>622,877</b>	<b>1,877,096</b>

**8. Llogari të arkëtueshme nga konçensioni**

Më 31 dhjetor 2016, aktivi financiar është njohur në masën 43% të kostove të ndërtimit të realizuara deri në momentin e raportimit ose 1,147,980 mijë Lekë (2015: 1,229,935 mijë). Ndarja që Shoqëria i bën kostove të ndërtimit të aktivitetit konçesionar shpjegohet në shënimet 3.2 dhe 3.4. Aktivi financiar matet me kosto të amortizuara. Zhvlerësimi i aktivitetit financiar gjatë vitit 2016 ka qenë 81,956 mijë lekë, llogaritur duke marrë parasysh skadimin e të drejtave kontraktuale të aktivitetit financiar.

**9. Aktive afatgjata jo-materiale**

	Të drejta nga konçensioni
Më 1 janar 2015	1,076,645,647
Shtesa	563,268,324
Më 31 dhjetor 2015	1,639,913,971
Shtesa	-
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,639,913,971</b>
<b>Amortizimi</b>	
Më 1 janar 2015	-
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2015	-
Shtesa	-
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>-</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>	
Më 31 dhjetor 2015	1,639,913,971
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,639,913,971</b>

**10. Aktive afatgjata të tjera**

Tabela më poshtë paraqet parapagimet ndaj kontraktorëve për ndërtimin e objektit të konçensionit.

	31.12.2016	31.12.2015
Global Hydro GmbH	14,429,598	-
Aquaterra Z.T	9,539,124	-
Freiland Z.T GmbH	7,547,700	-
Të tjera	82,188	14,648,342
<b>Totali</b>	<b>31,598,610</b>	<b>14,648,342</b>

**Lengarica & Energy sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***11. Llogari të pagueshme**

Shuma 226,263 mijë Lekë (2015: ALL 327,187 mijë) konsiston kryesisht në shërbimet e konsulencës ligjore dhe teknike. Shuma prej 173,823 mijë lekësh është e pagueshme për Trema Engineering 2 sh.p.k dhe bilanci i mbetur është e pagueshme për furnitorë të tjerë.

**12. Detyrime të tjera**

	31.12.2016	31.12.2015
Paga të personelit	641,240	370,488
Detyrime tatimore për TAP	186,522	105,987
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	202,242	102,572
Detyrime për tatimin në burim	31,843	67,583
Detyrime të tjera për taksat në lidhje me huamarrjen	-	12,198,083
Detyrime te tjera	837,370	-
<b>Totali</b>	<b>1,899,217</b>	<b>12,844,713</b>

Detyrimet tatimore për tatimin në burim lidhen me interesat e huave të marra nga Shoqëria me qëllimin financimin e ndërtimit të hidrocentralit.

**13. Huamarrjet**

	31.12.2016	31.12.2015
Huatë nga palët e lidhura	899,433,720	913,068,560
Huatë nga Green for Growth	1,039,853,928	1,111,914,778
Huatë nga OeEB	569,241,180	608,689,031
Interesi i përlogaritur me palët e lidhura	167,406,238	119,725,239
Interesi i përlogaritur me Green for Growth	-	-
Interesi i përlogaritur me OeEB	-	-
<b>Totali</b>	<b>2,675,935,067</b>	<b>2,753,397,608</b>

Gjatë vitit 2016, Shoqëria pagoi këstet sipas skedulit të huasë nga Green For Growth Fund (GGF) dhe Southeast Europe S.A., SICAV-SIF dhe OesterreichischeEntwicklungsbank AG (OeEB). Huaja maturohet më 15 qershor 2028. Norma e interesit që aplikohet mbi huanë është shuma e marzhit prej 6% ne vit, EURIBOR-it dhe kostove të detyrueshme nëse ka.

Huatë nga Enso Hydro Energji sh.p.k të përbëra nga vlerat e mëposhtme, janë përdorur për investime në objektin e konçensionit. Interesat e aplikuar gjate vitit 2016 ishin 5.5% (nga Qershor 2015; 5.5%).

Huadhenesi	Vlera e huase ne ALL'000	Vlera e huase ne EUR '000	Monedha	Data e huase	Interesi i perllogaritur ne ALL'000
Enso Hydro Energji shpk	135,230	1,000	EUR	18.07.13	31,325
Enso Hydro Energji shpk	40,569	300	EUR	25.10.13	8,587
Enso Hydro Energji shpk	18,932	140	EUR	02.10.13	3,980
Enso Hydro Energji shpk	540,920	4,000	EUR	04.11.13	109,000
Enso Hydro Energji shpk	13,524	100	EUR	12.06.15	1,250
Enso Hydro Energji shpk	150,259	1,111	EUR	03.07.15	13,264
<b>Totali</b>	<b>899,434</b>	<b>6,651</b>			<b>167,406</b>

Huatë e dhëna nga Enso Hydro Energji sh.p.k jane borxh i varur i pagesës së plotë të të gjitha detyrimeve sipas marrëveshjes së huasë së Lengrica&Energy sh.p.k me huamarrësit Green for Growth Fund dhe OesterreichischeEntwicklungsbank.

**14. Kapitali i paguar**

Kapitali i nënshkruar përbëhet 733,000 kuota me vlerë nominale ALL 1,000 Lekë për kuotë. Të gjitha kuotat janë paguar tërësisht. Gjatë 2014, nuk ka pasur lëvizje në kapitalin e paguar.

	Nr. i kuotave	Vlera nominale
Më 1 janar 2015	733,000	733,000,000
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>733,000</b>	<b>733,000,000</b>

**Lengarica & Energy sh.p.k.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**14. Kapitali i Paguar (vazhdim)**

ALL '000	Enso Hydro Energji sh.p.k	Hasi Energji sh.p.k	Vlera Nominale
Kapitali i paguar	732,980	20	<b>733,000</b>
<b>Në %</b>	<b>99.997%</b>	<b>0.003%</b>	<b>100%</b>

**15. Të ardhurat**

	31.12.2016	31.12.2015
Shitje enegjie	222,597,134	10,943,955
Të tjera	143,016,438	27,458,000
<b>Totali</b>	<b>365,613,572</b>	<b>38,401,955</b>

**16. Shpenzime për personelin**

	31.12.2016	31.12.2015
Pagat e personelit	9,681,548	4,495,941
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,027,138	428,270
<b>Totali</b>	<b>10,708,686</b>	<b>4,924,211</b>

**17. Shpenzime të veprimtarisë**

	31.12.2016	31.12.2015
Shpenzime per projektin Lengarica	96,793,812	-
Shpenzime siguracioni	16,658,505	8,650,067
Shpenzime Licence dhe Koncension	4,904,364	-
Te tjera	3,960,359	3,433,438
Shpenzime administrative	3,737,501	3,872,273
Konsulencë ligjore	3,284,483	3,892,346
Shpenzime për auditim dhe konsulencë takse	2,406,303	2,751,093
Shpenzime për makina dhe qira	2,086,244	1,769,571
Shpenzime per qira toke	1,846,640	2,368,465
Qira	1,003,600	1,020,368
Shpenzime telefoni	809,126	687,811
Taksa te ndryshme	662,983	39,735
Shpenzime udhëtimi	544,173	1,740,736
Shpenzime zyre	515,091	724,375
Shpenzime perfaqesimi	432,050	1,603,229
Shpenzime të tjera konsulence	269,748	652,056
Post	225,366	197,845
Shpenzime internet	165,594	562,598
Shpenzime perkthimi	165,516	325,000
Shpenzime për pale të lidhura	-	3,336,449
<b>Totali</b>	<b>140,471,458</b>	<b>37,627,455</b>

**18. Të ardhura dhe shpenzime financiare**

	31.12.2016	31.12.2015
Shpenzime interesi	(159,921,745)	(151,141,759)
Fitim/humbje të realizuara nga kursi i këmbimit	38,749,052	56,050,373
Të tjera	-	4,271,508
<b>Totali</b>	<b>(121,172,693)</b>	<b>(90,819,878)</b>

Shpenzimet financiare janë kapitalizuar në koston e aktivitetit koncesionar gjatë vitit 2014. Gjatë vitit 2015 dhe 2016, nuk janë kapitalizuar në përputhje me SKK të përmirësuar.

**Lengarica & Energy sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***19. Tatim fitimi**

Shpenzimi i tatim fitimit është si më poshtë:

	2016	2015
Tatim fitimi i vitit	-	-
Tatimi i shtyrë	(9,230,516)	-
<b>Shpenzimet e tatim fitimit për vitin</b>	<b>(9,230,516)</b>	<b>-</b>

Norma e tatimit mbi fitimin e Shoqërisë është 15% për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 (2015:15%).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetë-deklarime provizore deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin përfundimtar. Legjislacioni fiskal shqiptar është subjekt interpretimesh nga autoritetet fiskale.

	31.12.2016	31.12.2015
Fitimi/ (Humbja) e vitit	10,857,846	(95,596,836)
Pagesa tatimore teorike me normë statutores	1,628,677	(14,339,525)
Efekti tatimor i artikujve që nuk janë të zbritshëm ose të vlerësueshëm për qëllime tatimore:		
Shpenzimet e pazbritshme	5,392,565	8,012,185
Shfrytëzimi i humbjeve tatimore të bartura	2,209,274	-
Humbjet tatimore të panjohura të bartura për vitin	-	6,327,340
<b>Tatim fitimi</b>	<b>9,230,516</b>	<b>-</b>

**Tatimi i shtyrë**

Diferencat mes SNRF-ve dhe rregulloreve të tatimit në fuqi në Shqipëri krijojnë diferenca të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit financiar dhe bazave të tyre tatimore. Diferencat mes zhvlerësimit të të arkëtueshmeve nga koncesioni për qëllimet e SNRF-së dhe shpenzimeve të amortizimit për qëllime statutores, sjellin një tatim fitim prej 9,230,516 lekëve.

**20. Palë të lidhura**

Balancat dhe transaksionet e Shoqërisë me palët e lidhura në datën e bilancit janë si më poshtë:

	Marrëdhënia	31.12.2016	31.12.2015
<b>Aktive</b>			
<b><u>Kliente</u></b>			
Enso Hydro Energji sh.p.k.	Shoqëria mëmë	-	98,156
<b>Detyrime</b>			
<b><u>Hua</u></b>			
Enso Hydro Energji sh.p.k.	Shoqëria mëmë	1,066,839,960	1,029,511,576
<b><u>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</u></b>			
Enso Hydro Energji sh.p.k.	Shoqëria mëmë	944,785	5,223,020
Enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë	23,298,237	68,518,782
<b>Pasqyra e performancës</b>			
<b><u>Shpenzime operative</u></b>			
Enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë	26,056,696	3,336,449
<b><u>Shpenzime interesi</u></b>			
Enso Hydro Energji sh.p.k.	Shoqëria mëmë	49,468,854	58,261,495

## 21. Angazhime dhe detyrime e të drejta të kushtëzuara

### **Detyrime të kushtëzuara ligjore**

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së biznesit, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore. Sipas opinionit të menaxhimit, dispozita përfundimtare e këtyre çështjeve nuk do të ketë një efekt të dëmshëm material mbi pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshimet në aktivet neto.

### **Detyrime të kushtëzuara fiskale**

Legjislacioni tatimor shqiptar në fuqi në fund të periudhës raportuese është subjekt interpretimesh të ndryshme kur zbatohet ndaj veprimeve dhe aktiviteteve të shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor i përcaktuar nga drejtimi dhe dokumentacioni formal i cili mbështet këtë pozicion mund të kundërshtohet nga autoritetet tatimore. Periudhat fiskale konsiderohen të hapura për rishikim të çështjeve tatimore nga autoritetet fiskale për tre vite kalendarike duke filluar nga viti para se të merret një vendim në lidhje me rishikimin. Në raste të caktuara, rishikimet mund të mbulojnë një periudhë më të gjatë.

Detyrimet e regjistruara në lidhje me pozicionin fiskal të shoqërisë janë përcaktuar nga drejtimi duke u bazuar në rezultatet më të mundshme në rast se përllogaritjet do të kryheshin nga autoritetet fiskale. Vlerësimi bazohet në interpretimet e legjislacionit tatimor që është në fuqi në fund të periudhës së raportimit dhe ndonjë vendim gjyqësor apo interpretim i njohur i autoriteteve. Detyrimet për penalitete, interesa dhe tatime të tjera përveç tatimit mbi të ardhurat njihen në bazë të vlerësimeve më të mira të drejtimit në lidhje me shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës së raportimit.

Investimi total i rënë dakord në lidhje me marrëveshjen e koncesionit që duhet bërë është 1,908,714 mijë lekë. Tarifa e koncesionit e cila do paguhet nga shoqëria është 2.1% e energjisë së prodhuar. Shoqëria gjithashtu është e detyruar të investojë 42% të vlerës totale të investimit në makineritë dhe pajisjet në mënyrë që të transferojë aktivin tek pala kontraktore në kushte të plota operimi.

### **Angazhimet e qirasë operative**

Shoqëria ka hyrë në një angazhim qiraje operative për të marrë me qira ambientet e zyrave, për një periudhë dy vjeçare me një kosto mujore 574 Euro (6,888 Euro në total). Kjo kontratë do të rinovohet automatikisht pas dy vitesh pa qenë nevojta e një miratimi paraprak të qiradhënësit dhe qiramarrësit.

## 22. Menaxhimi i riskut financiar

### **a. Risku i kredisë**

Tabela vijuese prezanton ekspozimin e shoqërisë ndaj riskut të kredisë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Aktivet monetare	212,720,612	453,071,963
Tituj të tjerë të huadhënies (konçensioni)	1,147,979,779	1,229,935,478
<b>Totali</b>	<b>1,360,700,391</b>	<b>1,683,007,441</b>

### **b. Risku i likuiditetit**

Risku i likuiditetit është risku me të cilin shoqëria do hasë vështirësi në gjetjen e fondeve për të përmbushur angazhimet që lidhen me instrumentet financiare. Shoqëria monitoron likuiditetin e saj në baza periodike në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj, si dhe kur ato maturohen.

Tabelat e mëposhtme të likuiditetit janë hartuar duke u bazuar në maturimet kontraktuale të paskontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare,

**Lengarica & Energy sh.p.k.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**22. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**

**b. Risku i likuiditetit (vazhdim)**

	31 dhjetor 2016			Totali
	Më pak se 1 muaj	Nga 1 muaj në 1 vit	Nga 1 deri në 5 vjet	
Aktivet monetare	212,720,612	-	-	212,720,612
Tituj të tjerë të huadhënies (konçensiononi)	-	-	1,147,979,779	1,147,979,779
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>212,720,612</b>	<b>-</b>	<b>1,147,979,779</b>	<b>1,360,700,391</b>
Të pagueshme për akt e shfryt.	-	226,263,070	-	226,263,070
Huatë	167,406,238	-	2,508,528,829	2,675,935,067
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>167,406,238</b>	<b>226,263,070</b>	<b>2,508,528,829</b>	<b>2,902,198,137</b>
<b>Neto</b>	<b>45,314,374</b>	<b>(226,263,070)</b>	<b>(1,360,549,050)</b>	<b>(1,541,497,746)</b>
	31 dhjetor 2015			
	Më pak se 1 muaj	Nga 1 muaj në 1 vit	Nga 1 deri në 5 vjet	Totali
Aktivet monetare	453,071,963	-	-	453,071,963
Tituj të tjerë të huadhënies (konçensiononi)	-	-	1,229,935,478	1,229,935,478
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>453,071,963</b>	<b>-</b>	<b>1,229,935,478</b>	<b>1,683,007,441</b>
Të pagueshme për akt e shfryt.	-	327,186,785	-	327,186,785
Huatë	218,187,947	-	2,535,209,661	2,753,397,608
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>218,187,947</b>	<b>327,186,785</b>	<b>2,535,209,661</b>	<b>3,080,584,293</b>
<b>Neto</b>	<b>234,884,116</b>	<b>(327,186,785)</b>	<b>(1,305,274,183)</b>	<b>(1,397,576,852)</b>

**c. Risku i kursit të këmbimit**

Risku i kursit të këmbimit, është risku se vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit. Shoqëria kryhen transaksione në monedhë të huaj që lidhen me aktivitetin financiar dhe operativ të saj. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument të veçantë për tu mbrojtur ndaj këtij risku. Pjesa më e madhe e transaksioneve të shoqërisë është në Euro dhe në Lekë dhe duke qënë se kursi i këmbimit Euro/Lekë është i qëndrueshëm, risku i kursit të këmbimit konsiderohet i ulët.

31 dhjetor 2016	EURO	ALL	Totali
<b>Aktive financiare</b>			
Aktivet monetare	191,526,971	21,193,641	212,720,612
Tituj të tjerë të huadhënies (konçensiononi)	-	1,147,979,779	1,147,979,779
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>191,526,971</b>	<b>1,169,173,420</b>	<b>1,360,700,391</b>
<b>Detyrime financiare</b>			
Të pagueshme për akt e shfryt.	224,840,060	1,423,010	226,263,070
Huatë	2,675,935,067	-	2,675,935,067
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>2,900,775,127</b>	<b>1,423,010</b>	<b>2,902,198,137</b>
<b>Ndryshimi në kursin e këmbimit më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(2,709,248,156)</b>	<b>1,167,750,410</b>	<b>(1,541,497,746)</b>

**Lengarica & Energy sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)***22. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****c. Risku i kursit të këmbimit (vazhdim)**

<b>31 dhjetor 2015</b>	<b>EUR</b>	<b>ALL</b>	<b>Total</b>
<b>Aktive financiare</b>			
Aktivet monetare	222,131,544	230,940,419	453,071,963
Tituj të tjerë të huadhënies (konçensionit)	-	1,229,935,478	1,229,935,478
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>222,131,544</b>	<b>1,460,875,897</b>	<b>1,683,007,441</b>
<b>Detyrime financiare</b>			
Të pagueshme për akt. e shfryt.	314,547,876	12,638,909	327,186,785
Huatë	2,753,397,608	-	2,753,397,608
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>3,067,945,484</b>	<b>12,638,909</b>	<b>3,080,584,393</b>
<b>Ndryshimi në kursin e këmbimit më 31 dhjetor 2015</b>	<b>(2,845,813,940)</b>	<b>1,448,236,988</b>	<b>(1,397,576,952)</b>

**23. Ngjarje pas datës së raportimit**

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullime apo shënime të tjera shpjeguese në këto pasqyra financiare.